

“Bëjeni eksperiencën e lutjes, duke lejuar që Shpirti Shejt ti flasë zemrës tuaj. Të lutesh, do të thotë ti japësh pak prej kohës tënde Krishtit, të besohesh në Të, duke qëndruar në një qetësi dëgjuese të fjalës së Tij dhe duke e bërë që të tingëllojë në zemrën tuaj.”

SHËN GJON PALI.



Kisha ting Jeta

ORGAN I PËRMUAJSHËM INFORMACIONI I METROPOLISË TIRANË-DURRËS Nr. 5 MAJ 2017 Çmimi 30 lekë

MERRNI E HANI ...
KY ËSHTË KORPI IM

MERRNI E PINI ...
KY ËSHTË GJAKU IM



Kungimi i Parë në Katedralen e shën Palit

Papa Ipeshkvijve shqiptarë:
thirrjet, të rinjtë dhe shmangni
“mondanitetin” *faqe 3*

Deklarate e Komuniteteve fetare
në Shqipëri për situatën politike *faqe 3*

Një kafshatë buke
që ushqen përjetësinë
Nga Ferdinand NDOCAJ *faqe 4-6*

Papa në lutjen e Mbretëreshës
Qiellore kërkoi gjeste solidar-
iteti, mikpritjeje e dëshmi të
paqes së Zotit *faqe 7*

Unë, a ndjem
i dashur nga Jezusi? *faqe 7*

Imzot Charles John Brown,
Nunci Apostolik mbërrin në
Shqipëri *faqe 8*

Në Fatima-Papa Françesku
shenjtëron barinjtë e vegjël *faqe 8*

Ipeshkvi i Leiriës: Papa, profet
botëror kundër mureve *faqe 9*

550 vjet me- e-pa fugurën e
Zojës, Pajtores së shqiptarëve *faqe 9*

Zojës së Shkodrës *faqe 10*

Dioqeza Sapës kujton ipeshkvin
Imzot Lucjan Avgustini *faqe 11*

Kalendari Liturgjik

Qershor 2017



Themelimi i Eukaristisë

Mateu 26, 26-30

Ndërsa po hanin, Jezusi mori bukën, i dha lavdi Hyjit, e theu, ua dha nxënësve të vet e tha:

“Merrni, hani: ky është korpi im!”

Pastaj mori kelkun, u falënderua, ua dha e tha: “

Pini prej tij të gjithë, sepse ky është gjaku im gjaku i Besëlidhjes që do të derdhet për të gjithë në shpërblim të mëkateve. Unë po ju them: qysh tash nuk do të pi më kësi fryti hardhie deri atë ditë, kur, bashkë me ju, do të pi një verë të re në Mbretërinë e Atit tim.”

Dhe, pasi kënduan himnin, dolën për të shkuar në Malin e Ullinjve.

- 1 qershor - Sh. Justini
- 4 qershor - RRËSHAJËT (A)
- 5 qershor - Sh. Bonifaci
- 9 qershor - Sh. Efremi
- 11 qershor - TRINI SHEJTE (A)
- 13 qershor - Shna Ndou i Padovës
- 18 qershor - KORPI E GJAKU I KRISHTIT
- 21 qershor - Sh. Luigj Gonzaga
- 22 qershor - Sh. Niketa
- 23 qershor - ZEMRA E KRISHTIT
- 24 qershor - LINDJA E GJON PAGËZUESIT
- 25 qershor - E DIELA e XII GJ.V.A.
Sh. Cirili i Aleksandrisë
- 28 qershor - Sh. Ireneu
- 29 qershor - SHËN PJETRI E SHËN PALI
- 30 qershor - Sh. Martirët e parë të Romës



Drejtor i përgjithshëm:

Imzot George Frendo

Kryeredaktor:

D. Marjan Lumçi

Sekretar:

Ferdinand Ndocaj

Redaksia:

Kolec Çefa
Ana Stakaj
Zef Skanjeti
Elidon Dodaj

Grafika:

Pjerin Sheldija

Foto: Pici

Adresa:

Katedralja e Shën Palit,
Bulevardi Zhan D'Ark,
Tiranë, Shqipëri

E-mail: kisha.jeta@gmail.com

www.kishadhejeta.com

Papa Ipeshkvijve shqiptarë: thirrjet, të rinjtë dhe shmangni “mondanitetin”

Ipeshkvijtë e Kishës Katolike në Shqipëri kanë takuar Shenjtërinë e tij Papa Françeskun në Vatikan. Ipeshkvijtë janë në Romë për vizitën e tyre *ad limina*. Kjo është një vizitë që çdo ipeshkëv duhet ta bëjë çdo 5 vjet në Romë për t'u takuar me Papën dhe me dikasteret romake. Gjatë vizitës Papa Françesku, në një klimë të ngrohtë dhe vëllazërore, ka dëgjuar me kujdes gjithçka Ipeshkvijtë kanë thënë rreth jetës së Kishës shqiptare dhe angazhimit të tyre për ungjillëzimin.

Papa, pasi ka treguar solidaritetin e tij me Kishën në Shqipëri, i ka falënderuar ipeshkvijtë për misionin e tyre për ta ringjallur Kishën pas diktaturës ateiste dhe mizore komuniste. Ka kujtuar me mallëngjim vizitën e tij në shtator 2014, sidomos për praninë e shumë mijëra të rinjve. Ipeshkvijtë i kanë treguar atij se si komuniteti katolik është rritur gjatë këtyre 25 viteve.

Papa Françesku në fjalët e tij ka theksuar tre gjera: *së pari* se duhet të angazhohemi me shume për thirrjet për jetën meshtarake dhe jetën e kushtuar, duke inkurajuar të rinjtë



mos te kenë frike t'i thonë “po” Zotit; *së dyti* duhet të formojmë të rinjtë që të bëhen tharm në shoqëri; e ardhmja e Kishës dhe e shoqërisë varet nga ata; ja pse edhe Sinodi i Ipeshkvijve në 2018 do të ketë si temë “Të rinjtë dhe ungjillëzimi”; *së treti* të shmangim

“mondanitetin”, një shpirt materialist dhe konsumist.

Në fund të takimit Ipeshkvijtë i kanë dhuruar Atit të Shenjtë dy vëllimet me jetën e martirëve si dhe dy figura, njëren të Zojës së Këshillit të Mirë e tjetrën atë të martirëve.

Deklarate e Komuniteteve fetare në Shqipëri për situatën politike

DEKLARATE

Ne Komunitetet Fetare në Shqipëri, Komuniteti Mysliman, Kisha Orthodhokse Autoqefale, Kisha Katolike, Kryegjyshata Botërore e Bek-tashinjve dhe Vëllazëria Ungjillore, në përputhje me natyrën e veprimtarisë tonë shpirtërore, ndiejmë përgjegjësinë shpirtërore dhe morale që kemi për besimtarët tanë, por edhe për shoqërinë shqiptare në përgjithësi. Me anë të kësaj deklarate të përbashkët, duke u nisur edhe nga situatat e fundit të krijuara, ashtu sikurse edhe në ndonjë rast në të kaluarën, dëshirojmë t'i drejtohem klasës politike dhe të gjithë atyre që kanë përgjegjësi institucionale për të mirën e vendit.

Nuk është detyra jonë të gjejmë apo të tregojmë zgjidhje konkrete për situatën e krijuar. Ajo është punë e politikës, e cila ka fushën e saj të veprimit dhe është e mandatuar nga populli për këtë gjë. Falënderojmë Zotin për shumë punë të mira që janë bërë dhe po vazhdojnë të bëhen, si edhe për seriozitetin e shumë njerëzve që punojnë pa u lodhur, edhe pse shpesh të panjohur, në zbatim të ligjit e për të mirën e shoqërisë.

Por gjithashtu, ne jemi të shqetësuar për klimën e krijuar në vend e në mënyrë të veçantë:

- për mungesën e dialogut politik dhe të vullnetit për dialog për zgjidhjen e ngërçeve,

sidomos për çështjen e zgjedhjeve, që janë një instrument i domosdoshëm për mirëqenien shoqërore të shqiptarëve;

- për retorikën e dhunshme dhe përçmuese që përcillet nëpërmjet kanaleve të informimit publik dhe në rrjetet sociale nga ana e atyre që mbajnë poste apo kanë pozicione publike dhe të rëndësishme në jetën e vendit;

- për dukuritë e korrupsionit dhe të prodhimit të lëndëve narkotike, që dëmtojnë sot dhe në të ardhmen jetën e qytetarëve dhe mirëqenien e tyre;

Të gjitha këto që u thanë më sipër mund të rrezikojnë stabilitetin e vendit, që për ne është një e mirë e madhe për të gjithë shoqërinë e për çdo njeri dhe që duhet ta ruajmë me çdo kusht.

Prandaj, ne ftojmë me ngulm dhe me forcë të gjithë faktorët politikë në Shqipëri, nga ana e opozitës dhe e qeverisë, parti të vogla e të mëdha:

- për ndërtimin e urave dhe jo të mureve. Duhet një dialog i sqartë, i bërë në shumë nivele, duke përfshirë sa më shumë aktorë dhe faktorë. Keni përgjegjësi përpara popullit dhe duhet të mendoni për të qysh nga dita që keni marrë përsipër të hyni në politikë. E mira e popullit është synimi juaj madhor.

- për uljen e toneve të retorikës së dhunshme

dhe përçmuese ndaj kundërshtarit politik. Kjo vetëm nxehtë gjakrat dhe nxit veprime të dhunshme.

- për garantimin e një procesi parazgjedhor dhe zgjedhor transparent dhe gjithëpërfshirës. Në mënyrë të veçantë e sidomos u bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve të mos bien pre e tundimit të shitblerjes së votës apo të votimit nën kërcënim për vendin e punës që është buka e fëmijëve. Gjithashtu, u bëjmë thirrje të gjitha institucioneve që kanë përgjegjësi për zgjedhjet, që të luftojnë të gjithë dukurinë e shitblerjes së votës dhe kërcënimit për vendin e punës.

- për krijimin e kushteve që ligji dhe e drejta të sundojnë në jetën shoqërore të Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Po ashtu bëjmë thirrje që çdo nismë qytetare dhe politike për të shprehur mendimin dhe dëshirat të shërbejë për të mirën e përbashkët dhe të shmangë çdo lloj dhune ndaj njerëzve, objekteve dhe institucioneve.

Të bindur se me anë të kësaj deklarate po japim një kontribut për mbarëvajtjen e vendit, ne do të vazhdojmë të lutemi për të ardhmen dhe mirëqenien e vendit tonë.

Tiranë, 12 maj 2017

Komunitetet Fetare në Shqipëri

Një kafshatë buke që ushqen përjetësinë

Kungimi i Parë në Katedralen e shën Palit - Tiranë

Nga Ferdinand NDOCAJ

Eardhmja u përket atyre, sepse me përbajtjen ADN-së, ata janë edhe filizat edhe gjethet e reja që do ta përpunojnë klorofilën e do t'i japin ushqimin pemës së Krishtit; asaj peme, e cila mbetet e gjelbërt, e brishtë dhe gjithmonë e ripërtërirë, ndër mote, drejt përjetësisë.

Janë pikërisht këta fëmijë, që po vijnë pak nga pak, sëbashku me prindërit, vëllezërit e motrat, por edhe me të afërmit e tyre. Duke kaluar pragun e derës, ata hyjnë në oborrin e shenjtë të Katedrales së Shën Palit... Bashkohen me fëmijët e tjerë, buzagaz: me gjallërinë karakteristike që i bën t'i ndrijnë sytë. Sot është dita e tyre e shumëpritur. Po afrohet çasti, kur do të jenë pranë Elterit të shenjtë për të marrë sakramentin e Kungimit të Parë "me zemrën e mendjen të hapur".

Pasi kanë kryer rrëfimin, këta 19 fëmijë janë plotësisht të ndërgjegjshëm se jeta e tyre, tashmë po integrohet më mirë në rrugën e Krishtit, pikërisht ashtu siç thotë edhe Papa Françesku: "Kungimi është zemra e nismës së krishterë e madje është burimi i vetë jetës së Kishës". Sigurisht janë ngritur më herët se çdo të djelë tjetër. Është një preokupim mjaft i bukur për ta: janë të bindur se në jetën e tyre fëmijore do të ndodhë një ngjarje e madhe, krejt festive. Do të lërë gjurmë të thella për të ardhmen.

Për të mbërritur në këtë ditë, u bënë disa muaj që përgatiten e studiojnë së bashku me motrat; kanë zhvilluar shumë e shumë orë të bukura katekistike, në biseda të hapura e me interes, brenda atmosferës së një përsëritërie, për ta, të papërtuar më parë. Sigurisht, tani kanë mësuar t'i luten më mirë Jezu Krishtit, që sot i pret krahëhapur në Elterin e Katedrales. Ashtu, me krahët e shtrira përpara, tek ia hedh sytë asaj statuje, mbi të cilën është derdhur aq art, që t'i jepen trajtat në përgjigje të harmonisë së kompleksit arkitekturor modern që ka kisha, të duket sikur nga brenda gurit të latuar, vjen e përsëritur papushim jehona e fjalëve të Ungjillit të Gjonit: "Unë jam buka e jetës. Kush vjen tek unë, nuk do të ketë më kurrë uri, kush beson në mua, nuk do të ketë më etje" (Gjn 6, 35)...

Ndërkohë, motër Tereza Maria, motër Violeta së bashku me znj. Davita (katekisten e Motrave "Maria Mazzarello"), të cilat i kanë shoqëruar të



dyja grupet e fëmijë në këtë itinerar të gjatë disamujor, janë në mjediset e katekizmit së bashku me 19 fëmijët që po përgatiten të veshur si engjëj, krejt në të bardha. Nga jashtë, po nga ana e pasme e Katedrales vijnë zërat e gëzuar të fëmijëve të tjerë, që i kënaqen lojës: të mbledhur në një rreth të madh, ulen e ngrihen shend e verë; hera-herës dëgjohe zëri i motër Malvinës, që përpigjet të hyjë në botën e tyre, e njëherësh të instruktojë me detajet specifike të lojës saleziane...

Koha kalon shpejt. Brenda në Kishë, mbretëron qetësia e lutjes në një atmosferë festive që flet qartë ngado; jo vetëm në larminë e luleve të freskëta të zgjedhura enkas me aq shije nga motër Teuta dhe prindërit e fëmijëve, sipas arredimit të posaçëm që kërkon kjo ditë, por mbi të gjitha në Elterin e deri në bankat qendrore nga ku spikat ngjyra e bardhë e shiritave të najlonit. Nga kjo qetësi, dalin tingujt e lehtë muzikor, të cilat ndiqen nga zëri i lehtë koral. Ka nisur një Aleluja sinjalizuese e hyrjes për në ritualin e Meshës, ndërkohë që

besimtarët shoqërojnë me kokë procesionin e prirë nga kryqi. Në Kishë, në mënyrë evidente vihet re një përqindje mjaft e lartë e fëmijëve. Është tregues i padiskutueshëm i një famullie të re, ku dominojnë masivisht moshat e reja.

E famullitari, Dom Marjan Lumçi, pasi kemon Elterin, qiriun e Pashkëve, bashkësinë, por edhe Krishtin krahëhapur e madhështor që tërheq të gjitha shikimet e popullit të shumtë, ardhur në këtë event për Katedralen, thotë: "Sot, meshën, do ta nisim ndryshe. Imagjinoni se në qiell, sot, një grup fëmijësh do të takohen për herë të parë me Jezu Krishtin. E Krishti i pret ata...". Pak më tutje, nga amboni, Motër Violeta shton: "Po i paraqiten bashkësisë sonë, fëmijët që sot do t'i afrohen për herë të parë Mensës Eukaristike...". Më tej i kërkohet bashkësisë: "T'ia besojmë Zotit këtë kremtim. E të përpigemi të jemi për ta, dëshmitarë të shëndritshëm dëgjimi, dashurie dhe besnikërie...". Famullitari, i cili e kremton sot i vetëm ritualin e shenjtë, thërret secilin nga





fëmijët në emër. Ata janë: Ana Mulaj, Serxho Mataj, Noemi Fabiani, Mario Vukzaj, Stefanie Vocaj, Françeska Vocaj, Erjon Vukzaj, Ester Kaçi, Ana Guga, Erald Vukzaj, Ana Maria Nikolli, Ardjana Prendi, Adison Prendi, Manjola Prendi, Era Kasneci, Rovina Picaku, Aurel Gjuraj, Danjela Gjura, Xhoana Delia.

Njëri pas tjetrit, të shoqëruar nga prindërit e nunët, ata shkëmbejnë përsëritetjen me famullitarin dhe ulen në rreshtin e parë, të rezervuar për ta. Nësa ua prezanton fëmijët besimtarëve, Dom Marjani, nuk heziton që me pak shaka t'u bëjë edhe vëzhgimin se "përbërja e kandidatëve për Kungimin e Parë, sot është ndërkombëtare ashtu si vetë Kisha Katolike, pasi mes tyre kemi një vajzë italiane dhe dy të tjera që u kanë ardhur gjyshërit nga Peruja". Pastaj, duke iu drejtuar prindërve shton: "Pas shumë vitesh, do të jetë një tjetër moment i rëndësishëm në jetën e këtyre fëmijëve, kur së bashku me prindërit e tyre do t'i afrohen sërisht këtij Elterit të shenjtë për të marrë Kurorën e Martesës dhe ju do ti përcillni drejt dhëndrit apo nuses, por kjo ditë e sotme do të mbetet në kujtesë si më e rëndësishmja, sepse është hera e parë që po i afrohen Eukaristisë dhe ju po i përcillni fëmijët tuaj në takimin e Krishtin Dhëndërr"

Pas leximeve të ditës, në trajtë harku, para kremtuesit e para Elterit, të 19 fëmijët, shprehin njëzëri dëshirën për të marrë Jezusin. Vargu i pyetjeve e madje përgjigjet pohuese, përfundojnë me fjalët: "...me gëzim të madh, në emër të Kishës, e pranoj kërkesën tuaj; Jezusi qoftë gjithmonë miku juaj dhe ju pranofte tani e përgjithmonë".

Ndër të tjera gjatë Omelisë, Don Marjani vë në dukje se: "Sot janë shumë motive për të cilat duhet të jemi të gëzuar prej Zotit që na ka mbledhë këtu të gjithëve. Të djelën e ardhshme do të kremtojmë Ditën e Rrëshajave, pra zbritjen e personit të tretë, të të Shenjtës Trini, mbi apostujt. Kemi përpara një ngjarje të shënueme në vitin liturgjik, e cila na ban të reflektojmë shumë. Në anën tjetër, pjesa e Ungjillit dhe liturgia e sotme, pavarisht gëzimit që na transmeton mbrenda nesh, na ban të ballafaqohemi me një dukuri, që në dukje, krijon ndër-

prerje: në mënyrë paradoksale Jezusi largohet nga apostujt e tij. A është e mundun kjo? Do t'ia banim këtë pyetje vetes, duke dhanë kurdoherë, pa u menduar gjatë të njajtën përgjigje: E Pamundun... U thotë atyne pra se po iki, por njiherit do të jem me ju në të gjitha ditët e botës... E motivi i tretë i gëzimit të sotshëm, asht prania e shndritshme e këtyre fëmijëve të mrekullueshëm, që për herë të parë, po e ndiejnë Krishtin aq afër vetes, sa nuk e kanë pasun kurrë. E kjo, asht e vetmja ditë që liturgjikisht nuk vihet në Kishë me i thanë Zotit që 'Unë besoj në Ty'. Asht Zoti, Ai që na thotë sot 'Unë besoj në Ty, unë besoj në ju, prandaj dhe po ju la ta drejtoni Kishën time dhe kam me besue në ju në të gjitha ditët e jetës duke kenë i pranishëm në mesin tuaj si ushqimi i së përditshmes tuaj...'. Festa e sotme, na kujton edhe një tjetër të vërtetë të madhe, se Zoti Ynë me plagët e gjakun e shkaktuem prej njerëzve në trupin e vet, ngjitet tek Ati në qiell, qw do tw thotë se Trinia Shejte nw gjirin e saj ka fytyrën e secilit prej nesh. Pra jemi të pranishëm në gjirin e Trinisë'. Në vijim përmes një reflektimi mbi ripërtëritjen e Mbretërisë së Jeruzalemit tokësor, famullitari thekson se 'Krishti u konfirmon apostujve që të mos kenë frikë: Unë gjithmonë do të jem i pranishëm në jetën tuaj... e fëmijëve deshta me ju thanë: ju tashti e dini se jeni të zgjedhunit e Zotit... e ky Zot, përmes Pjetrit u thotë apostujve të vet: Lërin fëmijët të vijnë tek unë. Nësa unë gjithashtu deshta me ju porositë që, motër Violetën, Davitën e motër Tereza Marinë, mos i harroni kurrë. Ata ju kanë shoqnie ju, ashtu siç mund të shoqnojë një nanë e mirë, gjatë kësaj ecje sëbashku në fe. E nuk asht vetëm koha që kanë kalue me ju, që i ka afrue e i ka lidhë me ju ngushtësisht. Mbajeni të shenjtë këtë lidhje të ngushtë si e mban nana me fëmijën e vet. Dita e sotme, për ju, në një farë mënyre, në simbolikën e vet na kujton lindjen e fëmijës pas 9 muajve të vështira por edhe të mrekullueshme. Fëmija ma në fund të pritjes, e sheh dritën. Edhe ju sot keni pa dritën e vërtetë e të jeni të sigurtë se këto nana, ashtu si edhe nana qiellore, do të vazhdojnë t'ju kenë gjithmonë pranë. Edhe ju

vazhdoni t'i mbani gjithmonë sa ma pranë vetes. Urime e Zoti ju bekoftë!".

Mes qetësisë e reflektimit në lutje, pas disa çastesh, Motër Tereza Maria e motër Violeta së bashku me katekisten Davita, nga qiriu i madh i Pashkës, ndezin qirijtë e vegjël të Kungimit të Parë dhe ua japin fëmijëve. Është një veprim sa i thjeshtë aq edhe plot domethënie, që të shkakton mjaft emocion. Sytë e bashkësisë janë ngrirë mbi dritën e qiriut të Pashkës. Diku një e moshuar, që me siguri ka ardhur për ndonjë nip a mbesë të sajën, nuk mund t'i përmbajë lotët. Ka arsye. Pranë Elterit, po kryhet Gjesti i Qiriut të Ndezur, gjatë të cilit, Don Marjani përfundon: "Sot të dashur fëmijë, ajo dritë që keni marrë nga qiriu i Pashkëve, po iu dorëzohet pikërisht në ditën e takimit tuaj të parë me Jezusin Eukaristi".

Është një meshë disi më e gjatë se zakonisht, por në sytë e njerëzve vihet re gjallëria e pjesëmarrjes me vëmendje të përqendruar në çdo pasazh. Sigurisht, kjo bashkësi është e impenjuar që në lutje t'i shoqërojë këta krijesa të brishta, ndërkohë që bashkohet në një zë të vetëm me ta në Përtëritjen e Premtimeve të Pagëzimit: "Po, i bie mohit" e pastaj "Besoj". Stërpikja me Ujin e Bekuar të fëmijëve para Elterit të shenjtë, e pastaj edhe të gjithë bashkësisë, do të ndiqet nga një tjetër lutje që i ngrihet Zotit nga e gjithë bashkësia: "Dëgjoje, o Atë, lutjen tonë": është përgjigjja e Lutjes së Besimtarëve, e cila në këtë kremtim të shenjtë, u përket këtyre fëmijëve të mrekullueshëm, të veshur në shkëlqimin e bardhësisë hyjnore. Njëri pas tjetrit i afrohen ambonit, dikush me emocion e dikush tjetër duket më i qetë, por në konfrontimin e shikimit me të gjithë këtë masë njerëzish që mbush kishën, është e shpjegueshme të ekzistojë edhe një fare tronditje e brendshme. Natyrshëm, që ashtu si Kungimi edhe ky veprim përgjithësisht kryhet për herë të parë prej tyre.

Prezantimi i dhuratave, është një pjesë e ritualit që kryhet në solemnitët e në qetësi të plotë. Dëgohet vetëm një zë i vetëm që shpjegon përkushtinë që po i ofrohet Elterit. Lëvizjet janë të ngadalta. Buka e vera - Korpi e Gjaku i Krishtit; drita e qiriut





- simboli i Krishtit të Ringjallur, por edhe shporta për të varfrit që përmban ushqime të ndryshme, çka na bën të reflektojmë në bashkëndarjen njerëzore, nga duart e besimtarëve që vijnë dy e nga dy, kalohet në duart e famullitarit e më pas i përcillet Elterit të Shenjtë.

Ka ardhur momenti i shumëpritur i takimit me Zotin, që bëhet i pranishëm në trupin tonë nëpërmjet Eukaristisë. Përpara janë fëmijët, protagonistët e kësaj dite, e më pas vijon rreshti i gjatë i bashkësisë. Në këtë Kungim të Parë, nga 19 fëmijët, po merrret ajo dhuratë aq e vogël në dukje, por edhe aq e madhe dhe e çmueshme në përmbajtje. Është një kafshatë buke, që në një farë mënyre, i bën ata anëtarë të famullisë ku vijnë rregullisht; është një kafshatë buke që ushqen përjetësinë, duke i dhënë dritë nga drita e pasosur në shpirtin tonë të brishtë njerëzor. Gjithçka reduktohet në një qëllim të universalitetit që të çon në amshimin vezullues: të nxjerrësh në dritë këtë shpirt njerëzor, larg errësirave, që përpriqen të uzurpojnë e ta dhunojnë në kllapinë vdekjeprurëse, të gjithë rrjedhën e bukur të jetës.

Lutja pas kungimit sinjalizon se Kremtimi solemn po i afrohet fundit: "Jezus jemi këtu që të të themi se të duam, të adhurojmë e të falënderojmë, që erdhe në zemrat tona. Mos lejo të ndahemi kurrë prej teje. Të lutemi për çdo anëtar të kësaj bashkësie: për të rinjtë e të moshuarit. Mbi të gjitha të lutemi për të gjithë ata që janë duke përjetuar vuajtje shpirtërore apo trupore: bëj që të shohin në gjithçka dashurinë tënde dhe të dinë t'i tejkalojnë këto plagë. Të lutemi o Jezus, për shenjtërimin e meshtarëve tanë, e personave të shuguruar, të të gjithë bashkësisë sonë. Zemra jonë është e mbushur me falënderime, o Jezus. Të falënderojmë për dhuratën e Trupit dhe Gjakut Tënd. Të falënderojmë për dashurinë e prindërve tanë, për të gjithë personat që na kanë përgatitur për këtë ditë. Bekoji ata o Jezus, me hiret e Tua Na ndihmo që të mos harrojmë kurrë dashurinë tënde e të rritemi si të pëlqen ty: të aftë për të dashur njëri-tjetrin. Hiri yt, o Zot, dhe dashuria e Marisë, nëna Jote e nana jonë, na shoqëroftë gjithmonë".



Pas fjalëve të mbylljes dhe shenjës së Kryqit, vala e urimeve, përshkon zemrat feminare. Nuk kanë të sosur fotot buzë Elterit të shenjtë. Ashtu buzagaz, ata përqafohen me njëri-tjetrin, me prindërit, të afërmit e shokët e shoqet që u qëndrojnë pranë. Në qendrën e vëmendjes, janë edhe falënderimet e tyre për famullitarin, Dom Marjanin, por sigurisht edhe për motër Tereza Marinë, motër Violetën dhe znj. Davitën me të cilat shkëmbejnë edhe këtë kulmim të emocionit të tyre feminar.

Ana Maria Nikolli, është spostuar e vetmuar e në një copë letër nxitohet t'i shkruajë motër Tereza Marisë: "Është një bekim i madh për mua: sot mora Krishtin në zemrën time. Një ndjenjë e mrekullueshme ma rrënoqethi trupin. Në fillim të rrëfimit ndihesha e pasigurtë dhe e ndrojtur. Por, u desh pak kohë dhe u çlirova. Më erdhën në mendje të gjitha fjalët që na thojë ti motër në katekizëm... e pastaj, kur hyra në kishë, bashkë me prindërit e mi që më mbanin përdore, u ndjeva si në parajsë. Ndërsa i afrohem altarit, zemra më rrihte fort. Nuk e di përse, por pata frikë kur dola të lexoja lutjen e besimtarëve, para tërë atyre njerëzve që më shikonin vetëm mua. Nga emocioni gati më dridheshin gjunjët. Nuk do ta harroj çastin e marrjes së Korpit të Krishtit. E ndjeva Krishtin të gjallë në trupin tim. Ishte një ndjenjë e bukur".

Një tjetër fëmijë Ana Mulaj, pasi e ka përqaftuar Motër Violetën, duke e shikuar drejt



në sy, dëgjoj t'i thotë: "Sot, motër, isha shumë e lumtur, sepse erdhi ajo çfarë e kam pritur aq shumë: për herë të parë, unë e mora Trupin e Gjakun e Krishtit. Ishte ditë speciale për mua. Dua të falënderoj shumë ty motër, që na mësove sesi ta duam Krishtin".

Tek ndeshem përballë me znj. Davitën, i kërkoj një mbresë të shpejtë nga emocionin që ende e përjeton në zemër nga kjo ditë; e ajo më thotë: "Kur motër Violeta më propozoi që sëbashku t'i zhvillonim katekizmin këtij grupi fëmijësh, pranova menjëherë. Megjithatë, ka qenë një ide sa e bukur po aq edhe me përgjegjësi për mua. Me përgjegjësi, sepse ishte impenjim që kërkonte vullnet, përgjegjëshmëri vetijake dhe njëkohësisht dije e horizont për të përcjellur tek fëmijët mësimet e dubura, në mënyrë që ecja dhe formimi mbi sakramentet të ishin me themel, për vetë dhuratën që sot fëmijët do të merrnin. Falënderoj Zotin, për këtë dhuratë që ua bëri fëmijëve. Ata fluturonin nga gëzimi. Ishin të gjithë të lumtur, në kulmin e shkallëve të lumturisë. Natyrisht kjo ecje e tyre do të vazhdojë për ta shumë gjatë. Por nga dita e sotme, gjithçka do të jetë ndryshe: në zemrën e tyre tashmë do të kenë Jezusin, pikërisht atë Jezus, që e prisnin prej kohe. Jam e lumtur që familja e krishterë bëhet gjithnjë e më e madhe".

Aty pranë është edhe motër Violeta, e cila me modesti në momentin e parë heziton të japë një mbresë nësa e bëj me dije për shkrimin; pastaj shton: "E mirë... pa problem, dy fjalët... apo një ndjenjë e shpejtë e imja e këtij çasti në mbylljen e kremtimit festiv mund të përmbledhen thjeshtë: Takimi i sotëm i fëmijëve në Eukaristi me Krishtin, që një burim gëzimi i pafund për mua. Gjatë gjithë vitit, në përgatitje për këtë Sakrament, e kemi parë dhe e kemi ndjerë të gjallë, etjen e madhe që kanë fëmijët tanë për Krishtin. E them me bindje se kjo etje, nuk mund të shuhet nga askush. Një gjë e tillë sigurisht na bën të ndihemi mirë në besimin tonë, por në të njëjtën kohë, na motivon që ta rrisim gjithnjë e më shumë përgjegjësinë për ta shpallur Ungjillin e Krishtit".



Papa në lutjen e Mbretëreshës Qiellore kërkoj gjeste solidariteti, mikpritjeje e dëshmi të paqes së Zotit

“Gjeste solidariteti e mikpritjeje”. Këtë kërkoj Papa në lutjen e Mbretëreshës Qiellore kremtuar të Hënën e Engjëllit, në të cilën Kisha kujton kumtimin e Ngjalljes së Zotit. Françesku pohoi se jemi të thirrur për të qenë burra të ri e gra të reja, sipas Shpirtit Shenjt.

Papa i nxiti besimtarët të shpejtojnë, të shkojnë e t’ua kumtojnë burrave e grave të kohës sonë mesazhin e shpresës, që sjell me vete Ngjallja e Krishtit. Fjala e fundit nuk është më vdekja, por jeta! Françesku kujtoi se falë kësaj ngjarjeje, risi e vërtetë në histori e në kozmos, jemi të thirrur për të qenë burra të rinj e gra të reja, sipas Shpirtit Shenjt e për ta pohuar vlerën e jetës:

“Do të jemi burra e gra të ringjalljes, burra e gra të jetës, nëse, në mes të ngjarjeve, që e trondisin botën - e janë të shumta sot - në mes të mendësisë së botës, që të largon nga Zoti, do të dimë të bëjmë gjeste solidariteti, gjeste mikpritjeje, do të dimë ta ushqejmë dëshirën universale për paqe e dëshirën për një ambient të çliruar nga degradimi”.

Papa vërejti se bëhet fjalë për shenja të zakonshme e njerëzore, por që, të mbështetura e të frymëzuara nga besimi në Zotin e Ngjallur, fitojnë një forcë shumë më të madhe se aftësitë tona. E kjo, sepse - theksoi sërisht Françesku - Krishti është i gjallë; Krishti vepron në histori përmes Shpirtit të Tij Shenjt: i shpërblen mëkatet tona, arrin në çdo zemër njerëzore e ua rikthen shpresën gjithë të shtypurve e të vuajturve:



“Virgjëra Mari, dëshmitare e heshtur e vdekjes dhe ringjalljes së të Birit të saj, Jezus, na ndihmoftë të jemi shenja të kulluara të Krishtit të ngjallur ndërmjet ngjarjeve të botës, që kush është i zhytur në mjerim, të mos mbetet viktimë e pesimizmit, disfatës, nënshtrimit, por të gjejë mes nesh shumë vëllezër e motra, që i japin ndihmë e ngushëllim”.

Nëna jonë - uroi Françesku - na ndihmoftë të besojmë fort në Ngjalljen e Jezusit, që është këtu, ndërmjet nesh, e ky është mister mahnitës shëlbimi:

“Na ndihmoftë edhe të besojmë se Zoti ka aftësi t’i shndërrojë zemrat dhe jetën. E ndërmjetësorftë posaçërisht për bashkësitë e krishtera të persektuara e të shtypura në të katër anët e botës, të thirrura për një dëshmi më të vëshirë e më të guximshme”.

Edhe Sheshi i Shën Pjetrit ishte plot me besimtarë, grupe famullitare, familje, shoqata ardhur nga e gjithë Italia. Papa u kërkoj ta shfrytëzojnë çdo rast për të qenë dëshmitarë të paqes së Krishtit të Ngjallur.

E, së fundi ka qenë përshëndetja e popullit

Unë, a ndjehem i dashur nga Jezusi?”

“Unë, a ndjehem i dashur nga Jezusi?”, Kjo ka qenë ‘detyra’ që papa Françesku u ka lënë, të djelën e 7 majit, besimtarëve të pranishëm në sheshin e Shën Pjetrit, të cilët merrnin pjesë në recitim të lutjes së *Regina Caeli*, që gjatë periudhës pashkore zëvendëson *Engjëllin*.

Në kursin e katekizmit të tij të shkurtë, Papa në fakt, ka bërë thirrje lidhur me kujdesin mbi një përmasë të përvojës së krishterë mbase të lënë “disi’ në hije”; e pra bëhet fjalë mbi “përmasën shpirtërore e afektive”.

“Ngandonjëherë arsyetojmë së tepërmi mbi fenë, duke rrezikuar të humbasim perceptimin e vullës së vënë prej një zëri; prej zërit të Jezusit, si bari i mirë, që stimulon dhe mrekullon”, ka thënë Papa, i cili bënte fjalë për “përvojën e mrekullueshme të të ndjerit të dashur nga Jezusi”.

“Bëni pyetjen: “Unë a ndjehem i dashur nga Jezusin?”: kështu ka porositur Françesku mijra persona të pranishëm në sheshin e Shën Pjetrit (25.000 sipas vlerësimeve nga xhandarmëria vatikanase).

Në të djelën e katërt të Pashkës, në të cilën Kisha kremton “Të Djelën e Bariut të Mirë”, Papa ka qendëruar meditimin e tij mbi figurën e Bariut të Mirë në Ungjillin e Gjonit 10,1-10,



në veçanti mbi një dopio figurë: atë të Bariut e atë të derës së vathit.

Të dyja figurat, përmbledhen në personin e Jezusit, i cili është si “bariu i mirë” e po ashtu edhe si “dera e deleve”. Ai është “një udhëheqës, autoriteti i të cilit, shprehet në shërbim”, ka nënvizuar Papa, “një kryetar që për të urdhëruar jep jetën e nuk i kërkon të tjerëve që ta flijojnë këtë jetë.”

“Prej një bariu të tillë mund të besosh”, ka

shtuar ai, “ashtu sikurse delet që dëgjojnë zërin e bariut të tyre, pasi e dinë se me të shkohet në kullotat e mira dhe të bollshme.”

Por lipset të jesh i kujdesshëm, ka bërë me dije, pasi gjithmonë ekziston rreziku të jesh i hutuar nga zhurma e zërave të tjerë. “Sot jemi të ftuar që të mos e lëmë veten të shkëputur nga urtësitë e rreme të kësaj bote, por ta ndjekim Jezusin, Të Ringjallurin, udhëheqësin e vetëm dhe të sigurtë që i jep kuptim jetës sonë”.

Imzot Charles John Brown, Nunci Apostolik mbërrin në Shqipëri



Ka mbërritur sot në Shqipëri Nunci Apostolik Shkëlqesia e Tij Imzot Charles John Brown. Ai është caktuar nga Papa Françesku në Shqipëri pas mbarimit të shërbimi diplomatik të Shkëlqesisë së Tij Imzot Ramiro Molinar Ingles. Nunci i ri sot u prit në Nunciaturën Apostolike të Tiranës nga Ipeshkëvinjtë katolikë dhe nga një grup klerikësh dhe rregulltarësh katolikë që punojnë e veprojnë në Shqipëri.

Nunci Apostolik, në hierarkinë e Kishës Katolike, ka një rëndësi të veçantë, pasi ai është krahu i zgjatur i Papës pranë një Kisha lokale e po ashtu përfaqësuesi i Selisë së Shenjtë pranë shtetit. Mons Brown vjen në Shqipëri pas një përvojë disa vjeçare në Irlandë ku ka qenë i

caktuar Nunc nga Papa Bendikti XVI.

Në fjalët e para të tij sot ai tha se ka takuar para disa javësh Papën Françesku i cili i emocionuar i ka thënë: “Po të dërgoj në një komb të martirizuar. Mos rri i mbyllur në nunciaturë por dil e tako njerëzit, kishën lokale. Shko në periferitë për të takuar njerëzit.” “Jam i lodhur nga udhëtimi – shtoi Nunci i ri – se kam ardhur dirket nga Bostoni, por entuziast që do të jem në Shqipëri.”

Po ashtu në Nunciaturë mirësearchjen ia uroi edhe i ngarkuari me punë Mons. Romano Mbena dhe Shkëlqesia e Tij Imzot Angelo Massafra Arqipeshkëv i Shkodrës dhe Kryetar i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë.

Në Fatima Papa Françesku shenjtëron barinj të e vegjël

Një ditë maji, që do të mbetet e paharrueshme për Papa Françeskun dhe për shtegtarët e Fatimës: Në sheshin e madh para Shenjtores, Papa kremtoi Meshën e shenjtërimin të Xhaçinta e Françesk Marto, dy barinj të që, njëqind vjet më parë, panë në vegim, Zojën e bekuar. Vegimi u njoh nga Kisha si fenomen i mbinatyrshëm, që nga vitin 1930.

Gjithsesi duke u ndalur në vija të përgjithshme të shtegtimin, nga pritja e Papës, u vijua me lutjet prekëse e mbrëmësoren e së premtes, kremtuar nën dritën sugjestionuese të 600.00 qirinjtë të ndezur, që vezullonin si yjet në errësirën e natës së majit.

Para se të kremtonte Meshën, sipas programit, Papa pati një takim privat, në sallën e vogël të Shtëpisë “Nossa Senhora do Carmo”, me kryeministrin e Portugalisë, Antonio Luis Santos da Costa.

Pastaj u kremtua Mesha, me pjesëmarrjen e një turme vigane njerëzish. “Qielli vë në lëvizje këtu një mobilizim të vërtetë të përgjithshëm kundër kësaj indiference, që na e ngrin zemrën dhe e rëndon dritëshkurtësinë tonë. Nuk duam të jemi shpresë e dështuar!”. Këto fjalë u shprehën nga Françesku në homelinë e Meshës, kremtuar në njëqind vjetorin e dukjeve mariane gjatë së cilës shenjtëroi dy nga tre vegimtarët e Fatimës, vdekur në moshë të njomë nga epidemia e etheve spanjolle.

Në kremtim, sipas organizatorëve, morën pjesë një milion besimtarë. Të pranishëm, edhe presidenti i Portugalisë, i Paraguajt e i Sao Tomë.

“Jeta – kujtoi Papa Bergoglio gjatë homelisë - mund të jetohet vetëm falë bujarisë së një jete tjetër. Nëse kokrra e grurit, e rënë në tokë, nuk vdes, mbetet vetëm; por nëse vdes, jep shumë fryt”(Gjn 12,24); e tha dhe e bëri Zoti, që na paraprin gjithnjë. Kur kalojmë përmes një kryqi, Ai ka kaluar para nesh. Kështu,

nuk lartohemi mbi kryq për të gjetur Jezusin; por ishte Ai që u poshtërua dhe zbriti deri tek kryqi, për të na gjetur neve, për të ngadhënyer, në ne, mbi errësirën e së keqes e për të na çuar përsëri kah Drita.

“Nuk mund të mos vija këtu për të nderuar Virgjëren Nënë e për t’ia besuar bij e bija” - tha Papa në homelinë e Meshës së Shenjtërimin të dy barinjve të Fatimës. “Nën mantelin e saj nuk humbasin, nga krahët e saj vjen shpresa e paqja, për të cilën kanë nevojë e që unë e kërkoj në lutje për të gjithë vëllezërit e mi në Pagëzim e në natyrën njerëzore”, posaçërisht për sëmuret e të gjymtuarit, të burgosurit e të papunët, të varfërit e të braktisurit.

Të shumëdashur vëllezër, ta lusim Zotin me shpresë se njerëzit na dëgjojnë; e t’u drejtohem njerëzve me sigurinë se Zoti na ndihmon gjithnjë. Ai na krijoj si shpresë për të tjerët, shpresë reale dhe e realizueshme,

sipas gjendjes në të cilën jetojmë.

Papa citoi edhe një fragment nga vegimet e Xhaçintës të sapolumnuar, treguar sipas kujtimeve të vegimtares së tretë, Motrës Luçia dos Santos, vdekur më 2005, për të cilën vijon procesi i luminit. Luçia e përshkruan kështu vegimin e së kushërirës: “A shikon shumë udhë, shumë shtigje e ara plot me njerëz, që qajnë nga uria, sepse nuk kanë asgjë për të ngrënë? E Atin e Shenjtë në një kishë, para Zembrës së Papërlyer të Marisë, në lutje? E njerëz të panumërt, në lutje pranë tij?”.

Ju falënderoj, vëllezër e motra, që më shoqëruat!

Si e kreu Meshën, Françesku drekoi me ipeshkvijtë portugezë e me grupin, që e shoqëronte e, në përfundim, pas një ceremonie të shkurtër lamtumire në bazën ushtarake të Monte Real, u nis për Romë, ku arriti rreth orës së parashikuar, 19.05.



Ipeshkvi i Leiriës: Papa, profet botëror kundër mureve

Ishte ky, udhëtimi i 19-të apostolik i Papës Françesku, shtegtimi i tij pra, te Zoja e Fatimës në Portugali. Në sytë e të gjithëve mbeti përshëndetja e fundit e Atit të Shenjtë, ajo shami e bardhë, që së bashku me shamitë e bardha të 500 mijë besimtarëve, ndër të cilët edhe një grup shqiptarësh, i dhanë lamtumirën Zojës, mbajtur në krah në procesion, në fund të meshës për shenjtërimin e dy prej barinjve, të cilëve iu duk Virgjëra Shenjte: Françesku e Gjaçinta Marto.

Ati i Shenjtë Françesku mori me vete edhe përshëndetjen e ipeshkvit të Leirës, imzot Antonio Marto, i cili solli në meshë “përqaftimin dhe dashurinë e gjithë popullit katolik të Portugalisë dhe të të gjithë grave e burrave vullnetmirë”. Ju duan shumë, i tha ipeshkvi Papës. “Secili i ka sytë e ngulur te Papa Françesku – theksoi imzot Marto – si një zë profetik, që dëgjohet qartë në skenën botërore plot me rreziqe e frikë, në gjendje të shembë muret e ndarjes, të ndërtojë ura takimi ndërmjet njerëzve dhe popujve, të jetë zëri i atyre, që nuk kanë zë (të varfërit, të vuajturit e të mënjanuarit), të hapë rrugë shprese dhe paqeje”



550 vjet me- e-pa fugurën e Zojës, Pajtores së shqiptarëve

550 vjet me- e-pa fugurën e Zojës, Pajtores së shqiptarëve, titullohet i pari nga tre emisionet, që ia kushtojmë jubileut të zhvendosjes të Fugures së Zojës së Këshillit të mirë, nga Shkodra, në Gjencan.

Kanë kaluar 550 vjet nga dita, kur fugurja e Zojës së Shkodrës u shkëput nga muri prej nga ngushëllonte një popull të vogël, në luftë për jetë a vdekje kundër pushtuesit, që besonte se së shpejti do të ngulte gjysëmshënën mbi Shën Pjetër e çallmën mbi kokën e Papës. Një populli, që e pranoi krishterimin përmes veprës së Apostullit të madh, Shën Palit, i cili përhapi ndër Ilirë, mësimet e Jezu Krishtit. Krishterimi, i përndjekur nga një varg perandorësh, i lulëzuar nën sundimin e Kostandinit, e vetmja fe e pranuar kundër vullnetit të pushtuesit romak, tani vihej edhe një herë përballë një superfuqie të re të kohës: asaj të otomanëve. Rrebeshi i tyre u duk për herë të parë në tokën shqiptare kah fundi i shekullit XIV. Erdhën të ftuar nga vetë feudalët vendas të cilët, të verbuar nga egoizmi, nuk e kuptuan gjëmën e madhe, që po i përgatisnin kombit të vet.

Më 1467, një vit para vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, prania e turqëve në trojet shqiptare po bëhej gjithnjë më kërcënuese. Shoqërohej me rrënimin e plotë të fshatrave e me kërdi të paprera mbi popullin e pambrojtur.

Nga Kështjella, e cila sundonte mbi qytetin e Shkodrës, e fundmja që vijonte qëndresën, shiheshin fshatrat në flakë. Lëvizja e kobshme e flakës, fliste për përparimin e akinxhinjve turq drejt Shkodrës.



Në vitin 1467, si rrjedhim i një inkursioni turk, qyteti u braktis e qytetarët u mbartën mbi kodër, brenda kështjellës, ku jetuan deri më 1479, vit i mërgimit të madh drejt Venedikut. 1467-a është viti kur, sipas traditës, Fugurja shenjte e Zojës së Këshillit të Mirë u shpërngul nga Kishëza rrëzë Kështjellës Rozafa, për t'u ridukur në Gjencan ku, sipas gojëdhënës, u shoqërua nga dy shkodranë: Gjergji e Shkjau (Giorgi e De Sclavis).

Pasi venedikasit ia dorëzuan Shkodrën turqve, mbas nënshkrimit të Traktatit të Paqes

të 25 janarit 1479, nuk qe e mundur më të merreshin lajme, që të provonin shpërnguljen e Fugures Shenjte dhe traditën e lidhur me të në Shkodër.

Ipeshkvi Dillon vëren: “Një ngjarje me një shenjë paralajmëruese kaq fatzezë, duhet të ketë depërtuar thellë në zemrat e shqiptarëve të mjerë, që nuk kishin mundësi të mërgonin, ndërsa ata që nuk dëgjuan të mohojnë traditat, u lidhën edhe më ngushtë përreth fesë”

Kaluan vjet e vjet pa asnjë lajm nga Zoja mërgimtare. Derisa konti e kapedani Stefano Medin, më 25 korrik 1745, i dërgoi relacionin e parë, Giovanni Battista Medinit. Aty dëshmohej prania në Shkodër e një kishë të rrënuar, kush-tuar “Shenjtes Nunciatë”, që bënte mrekulli, ndërmjet të cilave, pengesa e përpjekjeve të ndryshme, e të kota, për ta kthyer kishën në xhami. Ndërkaq ata pak banorë të qytetit të Shkodrës, që kishin mbetur ende pa mërguar ose pa marrë malet, ishin dy mendimesh: disa mendonin se fugurja ishte mbartur, të tjerë, se ishte nisur vetë. Prej këndeje, gojëdhëna e kapërcimit të detit me dy shoqërues, që ecën mbi ujë, si në Besëlidhjen e Vjetër, duke ndjekur Zojën shtegtare mbi re. Me këtë tematikë, më pas, do të krijoheshin një mori kompozimesh në pikturë. E do të vinin edhe dëshmi të tjera, që tashmë janë të shkruara në historinë e kohëve të reja, kur për këtë ngjarje mund të shfletohen një mori librash. Një hollësi, që vlen të kujtohet, është se përmasat e zgavrës, krijuar nga shkëputja e fugures, përkrijnë me përmasat e pikturës.

E është për t'u kujtuar edhe se kuvendi a koncili i tretë i Kishës në trojet shqiptare (1895) e propozoi si mbrojtëse e pajtores të Shqipërisë e të shqiptarëve Zojën e Këshillit të Mirë, e njohur përgjithësisht si Zoja e Shkodrës. Ky vendim u mor dhe iu parashtrua Papës Leoni XIII, Papa i Rerum Novarum, që e miratoi menjëherë. E pikërisht pas këtij miratimi, 26 prilli u shpall si ditë kremtjeje për dioqezat e Shqipërisë.

Ndërkaq, përtej detit, larg trojeve të pushuara nga turku, Zoja e Shkodrës zuri vend në Gjenacan, jo larg Romës, e pikturuar mbi një copë suvaje muri katrore, me teknikën e afreskut. E gjatë 45 centimetra dhe e gjerë 40 centimetra, duket sikur qëndron e varur në ajër, duke u mbështetur vetëm paksa në pjesën e djathtë të bazamentit. Koka e Krishtit Fëmijë është pikturuar krejt pa flokë. Dikush ka thënë se është pikturuar kështu sepse në Shqipëri aso kohe ishte zakon që fëmijëve t'u qetheshin krejtësisht flokët. Koha kur u krijua kjo vepër arti dhe autori i saj nuk dihen me siguri. Në se nisemi nga stili i punimit, do të përcaktonim shekullin XIV si periudhë kur u krijua vepra. Sipas mendimeve, e më shumë dëshirave të shprehura deri më sot nga studiuesit shqiptarë, piktura mund të jetë vepër e ndonjërit nga 80 piktorët e shquar vendas, që përmenden në veprën e Gelçicit.

Kjo fugure, që gjeti pushim në një kishë të vjetër të Gjenacanit, nisi menjëherë të bëjë mrekulli, duke mbledhur rreth vetes turma të mëdha besimtarësh. Prej këndeje ndërtimi i një Shenjtëroreje të re, kushtuar Zojës së Këshillit të



Mirë, që u ngrit me dëshirën e Fra Felice Leonceli de Cave, augustinian, ndërmjet viteve 1621 dhe 1629, në vend të kishës së mëparshme, që thirrej "E Lumja Pietruccia". Nga kjo kishë, jo aq e bukur e me pak dritë, ruhet vetëm portali i viteve '400, të cilit, në vitin 1840, iu përshtat fasada e re, ndërtuar nga arkitekti Fra Fanucchi, edhe ky augustinian.

Në vitin 1956, fasadës iu shtuan mozaikë. Afresku i Zojës sonë të Këshillit të Mirë, ndodhet në kapelën anësore, majtas.

Papa i parë, që shkoi në shenjtëroren e Zojës së Këshillit të Mirë në Gjenacan ishte Urbani VIII, më 25 tetor 1630, për t'iu lutur Nënës së

Krishtit t'i shpëtonte njerëzit nga murtaja.

Në vitin 1993 Shën Gjon Pali II shkoi në Gjenacan për ta vizituar Zojën e Shkodrës, para se të nisej drejt Shqipërisë. E nuk u nis vetëm: e shoqëronte pikërisht Zoja e Këshillit të Mirë, një kopje e asaj ikone, në këmbët e së cilës luten sot mijëra besimtarë, që shtegtojnë në Kishën e rindërtuar tri herë rresht mbi gërmadhat e veta, rrëzë një Kështjelle-simbol. E tani Zoja i pret pa shkelur ende në Kishë, nga mozaiku mbi portën kryesore.

Kjo, tejet shkurtimisht, historia, që vijon... e që ne e titulluam "550 vjet me-e-pa fugurën e Zojës, Pajtores së shqiptarëve".

Zojës së Shkodrës

Nga Anonim

Thonë ke ikur,
larg je mërguar!...
Jo, Zoja e Shkodrës
askund s'ke shkuar.

Atje tej detit
ka shkuar ikona;
Zojë e Kalasë
je n'zemrat tona!...

U pa ndër shekuj,
shihet dhe sot:
Nga zemrat tona
Ti s'ikën dot!

Kush pat si ne
vuajtje pa masë?...
Kush na dha forcë?
Zoja e Kalasë!



Para torturash
e ndër burgime,
trimat të thirrën:
"O Zoja ime"!

Ball' pushkatimit,
Ty t'kishin n'gojë;
Fjalët e fundit;
"N'dor' tande, o Zojë"!

Ndër përdhunime,
ditë e përditë,
n'terr t'diktaturës,
kush na jep dritë?

Ndaj përtej detit
ka shkuar ikona;
Zojë e Kalasë
je n'zemrat tona!...

Idetë e liga,
Zojë, na pllakosën,
Kishat e tua,
tëra u rroposën.

Thua se s'qenë
djepi i lirisë,
thua s'u bënë
mbrojtë e Shqipërisë!

Thua dëm prej tyre
pati Atdheu,
thua s'qe falur
n'to Skenderbeu!

Por ani, Zojë,
Uratë ne themi,
si kishat tua
zemrat i kemi.

Ty t'kërkojnë ndihmë
në çdo t'vështirë,
Ti na e jep Zojë
K'shillën e mirë.

Se përtej detit
ka shkuar ikona;
Zoja e Kalasë
Je n'zemrat tona!

Ty nuk të lutet
veç krishterimi,
Ti je, o Zojë,
e çdo besimi.

Çdo shqiptar
kështu të flet:
"Zojë e Kalasë
kam ba' ni njet"!

Te Rozafati
rrëzë asaj kodre,
çdo ditë të hidhen
Ty lule shkodre.

Merre edhe këtë lule,
që t'a punova,
në shpirt më lindi,
Ty ta kushtova.

S'do i vë nënshkrim,
emën kurrfarë:
t'a dhuron Zojë,
Ty një shqiptar.

Ty amanet
t'la Shqipërinë:
"O Zojë e dashtun
na kthe lirinë"!

Se përtej detit
ka shkuar ikona;
Zoja e kalasë,
je n'zemrat tona!



Dioqeza Sapës kujton ipeshkvin Imzot Lucjan Avgustini

Dioqeza e Sapës kujtoi bariun e saj, ipeshkvin imzot Lucjan Avgustini, në përvjetorin e parë të kalimit në amshim, me një kremtim e përkujtim të veçantë, me një pjesëmarrje korale të klerit dioqezan, në krye me Administratorin Dioqezan të Sapës, Dom Simon Kulli, në praninë e Nuncit të ri Apostolik në Shqipëri, Imzot Charles John Brown, kryepeshkvit të nderit të Tivarit të Malit Zi, imzot Zef Gashi, ipeshkvit të Kosovës imzot Dodë Gjergjit, ish-Presidentit të Shqipërisë Alfred Mosiu e shumë të tjerë.

Dy ishin momentet kryesore të këtij përkujtimi: Kremtimi i Meshës Shenjte, udhëhequr nga imzot Zef Gashi dhe paraqitja e librit përgatitur nga Nest Zefi me titullin: "In Memoriam."

PËRVJETORI I KALIMIT NË AMSHIM TË IMZOT LUCJAN AVGUSTINI

Në përvjetorin e parë të kalimit në amshim të Imzot Lucjan Avgustinit, Dioqeza e Sapës ka kujtuar bariun e saj përmes një Kremtimi të veçantë të kësaj dite. Në sallën pranë selisë së tij, që e drejtoi për 10 vite me radhë, nën organizimin e familjes dioqezane të Sapës, ishin të pranishëm Nunci i Ri, Imzot Browun, Hierarkia e Kishës në Shqipëri, mbarë kleri i Sapës, i dioqezave të tjera të Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi; ishte gjithashtu ish Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Alfred Moisiu, autoritetet të larta shtetërore dhe civile, familjarët e tij si dhe besimtarët, që së bashku në këtë ditë përkujtimore nderuan figurën dhe veprën e tij.

Në emër të Dioqezës, Administratori Dioqezan Dom Simon Kulli përmes fjalës së tij të përshëndetjes dhe të mirënjohjes, falënderoi



Zotin për Imzot Avgustinin, për dashurinë e tij të shprehur në veprë për këtë vend dhe për popullin shqiptar gjatë gjithë viteve të jetës së tij meshtarake.

Përmes një ligjërate të shkurtër si kohë, por shumë e thellë në përmbajtje, rreth argumentit të çmuar mbi rolin, kontributin e individit në shoqëri, edhe ish presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Alfred Moisiu, kujtoi me shumë nostalgji ipeshkvin e paharruar Imzot Lucjan Avgustinin dhe vlerësoi kontributin e tij maksimal në rimëkëmbjen e Kishës Katolike në vendin

tonë. Vepra e tij duket si drita e diellit tha ai, që ky at shpirtëror nuk kurseu asgjë për lehtësimin e vuajtjeve të njerëzve kudo që i ka takuar.

Imzot Lucjani ishte njeriu i miqësisë me Zotin dhe njeriu. Një lidhje mjaft të ngushtë kishte dhe me shokun e fëmijërisë dhe vëllain në Krishtin Imzot Dodë Gjergjin, ku ky i fundit shprehi falenderimin ndaj Zotit që e ka pasur një vëlla të tillë duke kujtuar edhe momente të ndryshme gjatë jetës që kanë kaluar së bashku, ndërsa sot një pjesë e tij tha ai vazhdon të jetojë sërish me mua.

Edhe pse ka pak ditë që Shenjtëria e tij Papa Françesku emëroi Nuncin e Ri në Shqipëri, Imzot Charles John Broën, ai shprehi afërsinë që Ati i Shenjtë ka treguar me popullin shqiptar dhe me Kishën Katolike në Shqipëri. Në këtë përvjetor, me nxitjen e dom Simon Kullit dhe Dom Mark Shtjefnit, u promovua edhe libri i parë "In Memoriam" kushtuar Imzot Lucjan Avgustinit, me autor z. Nest Zefi. Është ky libër me një përbledhje kujtimesh, dhe një radhitje e virtyteve dhe karakteristike që përbënin Imzot Avgustinin.

E gjithë ceremonia përkujtimore kishte për kryefjalë emrin e nderuar të Imzot Lucjan Avgustinit. Edhe në kremtimin e Meshës Shenjte, mbajtur në Katedralen Shën Nënë Tereza, të gjitha lujtjet u drejtuan për shpirtin e tij dhe të gëzojë lumninë e parrizit. Siç e theksoi edhe ipeshkëvi i nderit të Tivarit, Imzot Zef Gashi, gjatë homelisë së tij: Thuhet se vdekja është shpendi grabitqar i jetës. E në rastin tonë, kjo thënie e ka kuptimin e plotë të fjalës. Deshtëm, s'deshtëm, jeta është ecje drejt vdekjes, njeriu është udhëtar kalimtar. Bibla na mëson dhe vërteton: Të lumët ata që vdesin në Zotin.

Kungimi i Parë

